



## Udhëzues

### mbi konkursin e pranimit

### në Akademinë e Filmit & Multimedias Marubi

## Kandidatët nga Shqipëria

Kandidatët pasi të kenë verifikuar emrin në listat e shpallura në AFMM, janë të lutur të paraqiten pranë Akademisë Marubi (Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr.78, Kinostudio, në krah të Ministrisë së Kulturës) **për procedurën e regjistrimit në konkurs.**

Për këtë qëllim secili kandidat duhet të ketë patjetër me vete :

1. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë) ;
2. Të kryejnë pagesën e tarifës së regjistrimit për konkurrim prej 5,000 (pesëmijë) Lekë, pagesë e cila duhet kryer në bankë në një nga llogaritë e Orafilm Marubi me të dhënat si më poshtë:

Union Bank (Leke): AL28 2141 1405 0111 1363 4502 0115

Raiffeisen Bank (Leke): AL11 2021 1013 0000 0000 7012 7150

Mbas kryerjes së pagesës, kandidati do të tërheqë pranë zyrës së financës së AFMM faturën tatimore.



## Informacion

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi është institucion i arsimit të lartë e licencuar që nga 2004 dhe e akredituar nga Ministria e Arsimit që në 2008 dhe në vazhdim. Gjithashtu, është anëtare me të drejtat të plotë,

prej 2008, e Shoqatës Ndërkombëtare e Shkollave të filmit CILECT.

Programi i studimit që ofron AFMM është Bachelor në Film dhe Media, dhe zgjasë tre vjet. Viti i parë është i përgjithshëm, viti 2 dhe 3 ndahet sipas profileve duke zgjedhur një nga 4 profile që ofron AFMM: Skenar, Regji, Kamera, ose Montazh. Këto katër profile formojnë të rinj në fushën e Kinematografisë dhe Televizionit, duke i dhënë përparësi jo vetëm formimit teorik por dhe kualifikimit profesional praktik të studentëve duke realizuar filma me metrazh të shkurtër brenda programit të AFMM, me pajisjet të vëna në dispozicion nga shkolla.

Tarifat e studimit në ngarkim të studentit janë:

Viti 1 = 1900€ (950€ semestri)

Viti 2 = 2000€ (1000€ semestri)

Viti 3 = 2000€ (1000€ semestri)

Pagesa bëhet ekskluzivisht përmes bankës.

Në AFMM, aplikojnë Maturantë, përmes platformës e Ministrisë së Arsimit, UALBANIA, dhe plotësojnë në sekretarinë e AFMM-së një formulari, dorëzojnë një Curriculum Vitae, një certifikatë të një gjuhe të huaj nëse kanë, një fotokopje të kartës së identitetit.

Pas publikimit i numrit të identifikimit në listat e përcjell nga UALBANIA, si dhe pagesës prej 5,000 leke në paraqitjen e dosjes së kandidaturës në sekretarinë e AFMM, ju lind e drejta të hyni në konkursin.

Konkursi konsiston në tre faza:

- test për kulturën e përgjithshme (me gojë),
- test për kulturën kinematografike (me shkrim),
- një ushtrim fotografik me 3 foto/story.

Gjithashtu testohet gjuha të cilën pretendoni se njihni, në rast mungese të certifikatës.